

## STATUTI I

### SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE

### KUFIZUAR "A-F -OIL KOMPANY" Shpk

Sot me daten 18/01/2018(tetembedhjete i pari dymije e tetebedhjete) ne qytetin e Korces duke u bazuar ne vullnetin e saj te lire, te plote dhe te sinqerte ne baze te ligjit nr.9901, dt. 14/04/2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare" neni 230 pika 2 ortake e vetme Aurora Njazi Hanxhara e datelindjes 7/08/1973 , me nenshtetesi Shqiptare i e dentifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr.H35807018M.

Ka hartuar kete akt themelimi te pershtatur ne ligjin nr 9901 dt 14/04/2008 lidhur me organizimin, administrimin dhe drejtimin e shoqerise tregetare "A-F-OIL KOMPANY" shpk Shoqeria eshte "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ku ortaket mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Kapitali i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

#### NENI 1

#### Emertimi i Shoqerise

Shoqeria tregetare do te mbaje emrin "A-F- OIL KOMPANY" shpk, i cili do të jetë stamposur dhe në vulën e saj dhe do te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat e nxjerra nga shoqeria dhe qe ju drejtohen te treteve . Per marrdheniet e saj me subjektet jashte territorit te Shqiperise , shoqeria do te mbaje te njejtin emertim me germa latine .

#### Neni 2

#### Objekti

Objekti i veprimtarise ekonomike dhe qellimi i shoqerise eshte:

Tregetim me shumice dhe pakice i lendeve djegjese si Diesel,Benzine ,Gaz (Pike karburanti ) lokal,lavazh,vajra motori,etj.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete mbi dhjete vjet,kohezgjatje e cila nis ne momentin qe ajo regjistrohet ne regjistrin tregetar prane QKR.

### **Neni 4**

#### **Selia e shoqerise**

Nr. Pas.175/155, zona kadastrale nr.1403

Selija e shoqerise ndodhet ne fshatin Bulgarec,Korce me adrese Rruga Nacionale Korce-Tirane kml.Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte [www.nikolhanxharashpk@gmail.com](mailto:www.nikolhanxharashpk@gmail.com).Shoqeria mund te krijojë dege dhe filjale ne rrethe te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

### **Neni 5**

Shoqeria tregetare " A-F-OIL COMPANY " shpk eshte subject juridik shqiptar dhe veprimtarine e saj e bazon ne legjislaturen shqiptare dhe kryesisht ne :

Ligjin nr 9901 date 14/04/2008" per tregetaret dhe shoqerite tregetare"

Regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar ndodhur ne QKR behet sipas dispozitave te ligjit nr 9723 date 03/05/2007 "Per qendren Kombetare te regjistrimit ".

### **NENI 6**

Personalitetin e saj ligjor Shoqeria e fiton nepermjet Vendimit te regjistrimit prane QKR.

## Neni 7

### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise ka vleren 10,000 Ieke i ndare ne 1 kuotë me vlere nominale 10.000 lekë

Kontributi ne kapitalin themeltar eshte ne masen e meposhteme nga administratorja;

- **Aurora Njazi Hanxhara**

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje shume me te vogel se shuma minimale e parashikuar nga ligji e detyron ta plotesoje ate, perndryshe ajo do te shpallet ne nje forme tjeter ose do te priset.

Kontributet ne shperblime nuk mund te shperblehet ne pjese me kapitalin themeltar.

## Neni 8

Shoqeria eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytezoje te drejtat materiale, ose jo malteriale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet.

## Neni 9

### Kuotat e kapitalit

Transferimet e kuotave te kapitalit duhet te vertetohen me akt noterial. Ato mund te fitohen apo kalohen nepermjet shitblerjes, dhurimit, me rruge trashegimnie ose ne cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Ne qofte se pjeset qe transferohen perbejne pasuri te perbashket, bashkeshorti i transferuesit duhet te jape pelqimin e tij. Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri. Ne kete rast

Shoqeria tregtare "A-F-OIL KOMPANY" shpk administrohet nga nje person fizik . Administrator I shoqerise tregtare "A-F-OIL" shpk eshte Znj. Aurora Njazi Hanxhara e datelindjes 7/03/ 1970, e cila do te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha veprimtarine e saj. Administratori emerohet per nje periudhe ( pese) vjecare me te drejte ripertesitje . Administratori mund te shkarkohet nga asambleja me shumice te zakonshme . Administratori kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise .

**Te gjitha veprimet qe ai mer duhet te jene ne pajtim me interesin e sipermarjes.**

**Administratori ka keto kompetenca:**

- Kryen te gjitha veprimet ne interes e shoqerise,pervec atyre qe shprehimisht kane ortaket.
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
- Komunikon asamblese se ortakeve inventaret,llogarite vjetore,raportin e administrimit,raportin e ekspertit kontabel.
- Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve,i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- Siguron zbatimin e vendimeve qe jep asambleja e ortakeve.
- Propozon krijimin e organeve te reja per permirsimin e punes.
- Perfaqson shoqerine tregtare ne organet administrative,gjyqesore doganore,fiskale,dhe zgjidhjen e mosmarveshjeve me te tretet.
- Nenshkruan per llogari te shoqerise kontrata.
- Lidhen kontrata individuale dhe ato kolektive te punes.
- Mban librat kontabel.
- Kryen cdo detyre tjeter te percaktuar ne ligjin"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"dhe ne statut.

Shoqeria mer persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administrimit dhe kur ato nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe aktet administratoreve e kalonin objektin e shoqerise.

Administratori nuk mund te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.Administratori mund te shkarkohet me vendim te asamblese se ortakeve.

Administratori mund te delegoje kompetenca te vecanta por nuk mund te delegoje teresine e kompetencave te tij.Administratores jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje ligjore,per shkeljen e ketij statute,per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.Administratori ka detyrimin e besnikerise ndaj shoqerise.

transferimi duhet te jete i miratuar nga ortaket ne kushtet e shumices se kerkuar per ndryshimet ne statut (shumica qe perben  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar).

Perfituesit qe perfitojne nga transferimi detyrohen te disponojne kapitalin e perfituar per nevojat e shoqerise, duke mare persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kishte mbajtesi i kapitalit. Transferimet ndermjet ortakeve kryhen lirisht. Ndryshimet ne pjeset te themeltar duhet te transferohen ne statut dhe ne QKR.

## **Neni 10**

### **Zmadhimi i kapitalit**

Zmadhimi i kapitalit vendoset me shumicen e parsahikuar me ndryshimet e statutit ( $\frac{3}{4}$  e pjeseve). Zmadhimi i kapitalit me ane te nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para behet duke depozituar per llogari te shoqerise ne nje banke fondet ne para. Pjeset e reja te kapitalit themeltar mund te nenshkruhen qofte nga ortaket ekzistues qofte nga persona jo ortake. Zmadhimi i kapitalit mund te behet nepermjet perfshirjes ne te rezervave te lira, te fitimeve te pashperndara. Zmadhimi i kapitalit plotesisht ose pjeserisht me ane te kontributeve ne natyre behet ne baze te nje raporti te ekspertit kontabel i emeruar sipas Legjislacionit Shqiptar. Kur pjese te reja te kapitalit themeltar nenshkruhen nga persona jo ortake keta duhet te miratohen nga shumica e ortakeve qe perfaqsojne  $\frac{3}{4}$  e ortakeve.

## **Neni 11**

### **Zvogelimi i kapitalit**

Zvogelimi i kapitalit duhet te autorizohet nga asambleja e ortakeve e cila mer vendimin te shumices se ortakeve qe perfaqsojne  $\frac{3}{4}$  e ortakeve. Realizimi i zvogelimit te kapitalit mund te arihet nepermjet zvogelimit te vleres nominale te pjeseve ose zvogelimi i numerit te pjeseve. Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet ne nje shumice me te vogel se minimumi ligjor.

## **Neni 12**

### **Asambleja e pergjithshme**



Organi vendimares i shoqerise eshte asambleja e pergjithshme. Asambleja e pergjithshme thiret nga administratori. Thirja e asamblese behet nepermjet nje njoftimi ne formen e nje shkrese drejtuar cdo ortaku ku te permbaje daten, oren, vendin e mbledhjes dhe rendin e dites dhe t'ju dergohet cdo ortaku jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Cdo mbledhje e thirur ne menyre te paregullt mund te anulohet.

Administratori duhet tu komunikojte ortakeve:

Inventaret, llogarite vjetore, Bilancin, vendimet e propozuara, raportin e administrimit, raportin e ekspertit kontabel. Asambleja miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Ortaket kane te drejte ti drejtojne pyetje me shkrim administratorit, i cili duhet tu pergjigjet ne mbledhjen e asamblese. Eksperti kontabel i autorizuar, kur ai ekziston ka te drejte te mare pjese ne cdo asamble. Asambleja e pergjithshme ka te drejte te emetoje dhe te shkaroje ekspertet kontabel, likujduesin e administratorin e shoqerise. Asambleja e pergjithshme ka te drejte te caktojte politikat tregtare te shoqerise, pjestimimin e kuotave, miratimin e pasqyrave financiare, transferimin ose pjestimimin e kuotave, riorganizimin e shoqerise, apo cdo lloj ceshtje tjeter te parashikuar ne statut apo ne ligjin "Per tregaret dhe shoqerite tregtare". Asambleja e pergjithshme duhet te shprehet per zmadhimin ose zvogelimin kapitalit, ndryshimin e objektit, dhe per prishjen e shoqerise si dhe per cdo ndryshim tjeter ne statut. Asambleja e pergjithshme vendos per ndryshimet ne statut, prishjen e shoqerise shitjen e pasurise se paluajtshme, makinerite e paisje, krijimin e filjaleve te reja, bashkimin e shoqerise. Ne asamble ortaku mund te perfaqsohet nga nje person tjeter sipas mandatit perkates. Asambleja e pergjithshme drejtohet nga administrator i shoqerise. Cdo vendim i ortakeve ose ortakut te vetem duhet te evidentohet me nje process verbal i cili hartohet ne nje regjister te posacem qe mbahet ne seline e shoqerise. Vendimet ne asamble e pergjithshme vendosen nga ortaket qe perfaqsojne me shume se gjysma e pjeseve te kapitalit themeltar.

Ndryshimet ne statut vendosen vendosen nga ortaket qe perfaqsojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rastin e vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja mund te mare vendime te vlefshme kur marin pjese ortaket me te drejte vote qe zotrojne me shume se 30% te kuotave.

## Neni 13

### Administrimi

Administratori eshte perfaqsesi ligjor i shoqerise ndaj te treteve. Ai kate gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rethanat.

Aurora Hanxhara me afat 5-vjeçar



## Neni 14

### Eksperti Kontabel

Asambleja e ortakeve cakton ekspert kontabel per nje periudhe prej 2 vite financiare .Emertimi i ekspertit behet nga asambleja e pergjithshme.Gjithashtu ai emeron dhe nje zevendes ekspert kontabel ne rast te mospranimit,pengimit dorheqjes ose vdekjes te ekspertit kontabel.Eksperti kontabel zgjidhet nga nje liste e hartuar nga organizimi professional i eksperteve kontabel.Nuk mund te jene eksperte kontabel administratoret e shoqerise si dhe paraardhesit dhe pasardhesit,bashkeshortet e tyre,themeluesit si dhe personat e afert deri ne shkallen e katert.

Eksperti kontabel mund te jape dorheqjen per arsye personale.

Eksperti kontabel ka per detyre:

- Te kontrolloje vlerat dhe dokumentat kontabel te shoqerise.
- Te kontrolloje pajtueshmerine e kontabilitetit te shoqerise me legjislacionin ne fuqi.
- Te verifikojte perputhjen me llogarite vjetore.

Eksperti kontabel nuk duhet te perzihet ne drejtimin apo administrimin e shoqerise.

Eksperti kontabel duhet te informoje administratorin per:

- Kontrollet dhe verifikimet qe jane kryer.
- Verejtjet per ndryshimet qe sipas tyre u duhen bere bilancit dhe dokumentit kontabel.
- Paregullsite dhe pasaktesite qe jane zbuluar.

Eksperti kontabel duhet te informoje asamblene e ortakeve per:

- Nje raport te pergjithshem per verifikimin dhe kontrollet e kerkuara nga ligji.
- Verejtje per llogarite vjetore
- Raport per zmadhim ose zvogelimin e kapitalit themeltar.

Eksperti kontabel mban pergjegjesi per shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerine e tyre.Eksperti kontabel eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj paleve te treat pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvlersimet e tyre gjate ushtrimit te funksioneve perkatese.

## **Neni 15**

### **Viti Financiar**

Rezultatet e veprimtarise te cdo shoqerie tregetare vlersohen periodikisht ne fund te cdo viti financiar. Kohezgjatja e cdo viti financiar eshte 12 muaj dhe perputhet me vitin kalendarik. Per te pasur llogari vjetore qe te pasqyrojne realisht pasurine dhe gjendjen financiare, shoqeria duhet te:

- Mbaje nje kontabilitet te rregullt ne perputhje me kerkesat e ligjit.
- Te kontrolloje inventarin ekzistues dhe vleren e pasurise ne mbyllje te vitit financiar.

## **Neni 16**

### **Fitimi**

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi I vitit financiar, te cilit I jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humjet apo fitimet nga vitet e meparshme.

## **Neni 17**

### **Dividentet**

Asambleja e pergjithshme mund te vendose shperndarjen e dividendeve vetem pasi:

- Te kete miratuar llogarite vjetore
- Te kete percaktuar shumen qe dote ndahet.

Cdo dividend I shperndare duke shkelur keto rregulla perben nje dividend fiktiv.

## **Neni 18**

### **Shnderimi, Bashkimi dhe likujdimi**



Shnderimi i shoqerise ne shoqeri kolektive ose komandite behet pasi paraqitet raporti mbi gjendjen e shoqerise nga nje ekspert kontabel dhe vendimi merret me miratimin unanimit te ortakeve. Shnderimi i shoqerise nga SHPK ne shoqeri anonime behet me vendimin e  $\frac{3}{4}$  te ortakeve sipas kushteve te percaktuar me ligj. Shoqeria mund te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te asamblese te pergjithshme. Shoqeria eshte ne likujdim e siper nga moment i prishjes se saj per cdo lloj shkakut pervec rastit kur kemi te bejme me bashkimin e pjeseve te kapitalit.

Kur vendoset prishja e shoqerise, asambleja e pergjithshme cakton likujdatorin, akt i cili regjistrohet ne regjistrin tregetar prane QKR.

Mbas mbylljes se likujdimit dhe depozitimit te dokumentave ne regjistrin tregetar, shoqeria cregjistrohet prej tij.

Likujdatori eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj paleve te treat per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvlersimet e tyre gjate ushtrimit te funksioneve perkatese.

### **Neni 19**

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar u hartua ne kater kopje, ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me deshiren e ortakeve.

**ADMINISTRATORJA**  
**AURORA HANXHARA**

---

Emër, Mbiemër, Firmë

